



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 10.09.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Arbërie Nagavci, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Albulena Balaj-Halimaj dhe Driton Çausi dhe Mufëra Shinik.

Munguan: Fidan Rekalii, Verica Çeraniq dhe Abdyl Salihu.

Përfaqësues të tjerë: KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4,10,11,18,23 dhe 25 korrik 2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijës dhe Teknologjisë;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të punës të komisionit për sesionin pranveror 2018;**
- 5. Shqyrtimi i planit të punës për sesionin vjeshtor 2018 dhe caktimi i prioriteteve;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4,10,11,18, 23 dhe 25 korrik 2018

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datat e lartpërmendura u miratuan me vërejtjen e deputetit Driton Çausi me arsyetimin se në dy procesverbale nuk është pasqyruar si duhet diskutimi i tij, ndërsa Nezir Çoçaj tha se miratimi i procesverbaleve do të duhej të bëhej në mbledhjen vijuese në mënyrë që të mos ketë kaq shumë vonesa.

Ismajl Kurteshi tha se vonesat e miratimit të procesverbaleve kanë ndodhur për shkak të mungesës së përkthimit në gjuhën serbe.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijës dhe Teknologjisë

Ismajl Kurteshi tha se komisioni ka përfunduar me shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit dhe sipas Rregullores është proceduar për shqyrtim në Komisionet e përhershme. Komisione e përhershme kanë shqyrtuar raportin me amendamente dhe kanë vlerësuar se amendamentet e propozuara janë pajtim me legjislacionin në fuqi, nuk kanë implikime buxhetore dhe nuk cenojnë interesat e komuniteteve.

Driton Çausi ngriti çështjen e nenit 6 që ka të bëjë me Këshillin e inovacionit shkencor dhe përfshirjen e përfaqësuesit nga Akademia e Shkencave dhe Universiteteve publike në këtë këshill.

Ismajl Kurteshi, lidhur me çështjen e ngritur, tha se komisioni ka përfunduar shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen me votim për raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijës dhe Teknologjisë.

Anëtarët e komisionit miratuan unanimitisht raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijës dhe Teknologjisë dhe i rekomandohet Kuvendit për lexim të dytë në Seancë plenare.

4. Shqyrtimi i raportit të punës të komisionit për sesionin pranveror 2018

Ismajl Kurteshi, në pika të shkurtra, prezantoi punët e kryera të komisionit gjatë sesionit pranveror: Shqyrtimi dhe Aprovimi i Ligjit për Inspektoratin e Arsimit dhe Projektligjin për Inovacion Shkencor dhe Transfer të dijes; Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet MASHT-it dhe Agjencisë Austriake për bashkëpunim me ADA; Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet MASHT-it dhe SPARK-ut nga Holanda, mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtarë në Mitrovicë; Janë zhvilluar dy tryeza të rumbullakëta, njëra për arsimin parashkollor dhe tjetra për arsimin e personave me aftësi të kufizuara; Shqyrtimin e raportit të Këshillit për Trashëgimi Kulturore. Gjithashtu gjatë sesionit pranveror ka filluar puna e grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe Ligjit për sponsorizime dhe donacione. Ai tha se projektligjet janë përfunduar ashtu siç kanë ardhur në Kuvend, me përjashtim të ligjit për statusin e punëtorëve të viteve të 90-ta që ka ardhur me vonesë.

Teuta Haxhiu tha se çdo punë e kryer nga komisioni është pak karshi obligimeve që i kemi. Sa i përket ligjit të statusit të punëtorëve të viteve të 90-ta, ajo tha se është në shqyrtim e sipër në komision dhe që duhet sa më parë ta procedojmë për miratim në Kuvend. Gjithashtu ngriti çështjen e disa lëshimeve teknike në Ligjin e Inspektoratit të Arsimit dhe kërkoi të dijë se çfarë do të ndodhë tutje dhe si do të përmirësohet, pasi që ligji ka hyrë në fuqi.

Në anën tjetër, sa i përket prioritetëve në sesionin vjeshtor, tha se duhet të punohet në projektligjin për statusin e punëtorëve të viteve të 90-ta, të përfundohet sa më shpejt që është e mundur dhe të mos bëhet politikë me këtë ligj, të bëhet një ligj i zbatueshëm. Gjithashtu ajo propozoi të fillohet me monitorimin e ligjit për sponsorizime dhe të shikohet se cilat ligje kanë nevojë më shumë për monitorimin e tyre.

5. Shqyrtimi i planit të punës për sesionin vjeshtor 2018 dhe caktimi i prioritetëve

Ismajl Kurteshi tha se bazuar në planin e punës për sesionin vjeshtor përveç projektligjit për statusin e punëtorëve pritet që të trajtohen edhe projektligji për Arsimin e Lartë, projektligji për Tekste dhe Mjete Shkollore, projektligji për Edukimin Parashkollor si dhe mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe ligjit për sponsorizime ku është kryer një pjesë e punës dhe po ashtu, ai tha se duhet kërkuar për shqyrtim raportin e punës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Ai tha se është me prioritet përzgjedhja anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. ndërsa lidhur me çështjen e ngritur për sa i përket korrigjimeve të gabimeve në Ligjin për Inspektoratin e Arsimit, tha se duhet ndjekur procedurat për plotësimin dhe ndryshimin e tij. Propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet Ministri i Arsimit, për të raportuar për përfundimin e vitit shkollor 2017/18 dhe fillimin e vitit shkollor 2018/19.

Teuta Haxhiu, sa i përket ligjit për Inspektoratin e Arsimit, tha se disa inspektorë veçse kanë filluar të vizitojnë zyrat rajonale, mirëpo që me ligjin e ri ata do të duhej të kishin një kualifikim më të lartë. Sa i përket raportimit të ministrit, tha se në raportimin e tij të futet edhe pajisja e

shkollave me tekste shkollore dhe pse brenda disa shkollave kanë tekste të ndryshme për paralele të ndryshme dhe gabimet që mund të jenë nëpër tekste shkollore. Sa i përket Agjencisë së Akreditimit, ajo theksoi që ministri do të duhej ta sjellë raportin mbi shkarkimin e kësaj agjencie si dhe që do të ishte mirë sikur deputetët të njoftohen për takimet e Agjencisë së Akreditimit, ajo këtë nuk e konsideroi si presion, por si mbështetje nga ana e Komisionit për Agjencinë për të diskutuar rreth shumë çështjeve, duke e përmendur numrin e vogël të studentëve të pranuar në Fakultetin e Mjekësisë, si dhe faktin që studentët e Kolegjeve Private shfrytëzojnë mjetet e këtij fakulteti dhe që nuk paguajnë asnjë taksë.

Nezir Çoçaj, në diskutimin e tij me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, uroi mësuesit, prindërit dhe nxënësit për zbatueshmërinë e kurrikulës së re në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar në Kosovë, duke e konsideruar një sfidë mjaft të madhe për të gjitha institucionet e Kosovës dhe që nuk duhet të mungojë puna e komisionit në ofrimin e të gjitha mekanizmave dhe bashkëpunimin të paktën me ministrinë dhe institucionet. Ai shprehu shqetësimin e tij për mungesën e drejtorëve në disa shkolla, si dhe për mos shpërndarjen e teksteve shkollore në disa shkolla, sidomos te klasat e para dhe ndikimin që mund të ketë te nxënia e njohurive të fëmijëve.

Sa i përket ligjit për statusin e mësimdhënësve, ai tha se në momentin që ka ardhur ky projektligj nga ministria, ka shkaktuar shumë konfuzion jo vetëm te shoqëria civile, por edhe te Qeveria, për nga mënyra se si është hartuar. Në anën tjetër, ai tha se nga Ministria i Arsimit duhet kërkuar raportim të punëve dhe rritje të buxhetit sepse sipas tij, zbatimi i kurrikulës së re nënkupton edhe buxhet më të madh dhe mjete shtesë.

Driton Çausi tha se që edhe pse është diskutuar disa herë për projektligjin për statusin e punëtorëve të viteve të 90-ta, konsideron që nuk është Komisioni Parlamentar i Arsimit, organi apo grupi i duhur i ekspertëve që duhet të jap vlerësimin përfundimtar. Ai tha se në takimet e Komisionit do të duhej të ishin të pranishëm edhe Ministri i Financave, i Arsimit dhe i Mirëqenies Sociale për të dhënë qëndrimet e tyre.

Nezir Çoçaj tha që pajtohet me qëndrimin e deputetit Çausit, por që anëtarët e komisionit janë bartësit e përgjegjësive politike dhe që Kuvendi apo edhe Presidenti duhet t' i zbatojë vendimet që dalin nga komisioni. Ai tha që në mbledhjet e mbajtura kanë qenë të pranishëm edhe zyrtarë të financave, edhe të arsimit, edhe të mirëqenies sociale, mirëpo që të tre palët kanë pasur qëndrime të ndryshme nga njëri- tjetri duke shkaktuar konfuzitet edhe më tepër. Ai tha se komisioni ka një pasqyrë mbi këtë projektligj dhe çka duhet të punojë dhe se është organi kompetent që duhet të marrë vendimin mbi këtë projektligj.

Driton Çausi tha se është përgjegjësi edhe e ministrave të vijnë në komision dhe të japin mendimin e tyre.

Ismajl Kurteshi tha se kur komisioni ka kërkuar sqarime nga ministrinë mbi projektligjin, kanë mbetur edhe më të hutuar se para së të marrin sqarimet. Ai tha se Ministri i Arsimit dhe i Financave kanë qëndrime të kundërta më njëri- tjetrin. Përderisa ai i Arsimit thotë që mësimdhënësit e meritojnë, ai i Financave, edhe pse nuk i mohon meritat, thotë që nuk ka buxhet

të mjaftueshëm, shtoi ai. Kundër këtij projektligji, Kurteshi tha që janë edhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Banka Botërore, FMN, GAP dhe BE.

Ismajl Kurteshi tha që është arritur një konkluzion në vija të trasha për këtë projektligj ku të ulet kostoja e këtij projektligji, mirëpo jo të hiqet totalisht.

Nezir Çoçaj tha se që me shifrat që kanë dalë nga Ministria e Financave dhe GAP-i, nuk e përkrah kalimin e këtij projektligji pasi që e shtyn shtetin në kolaps, mirëpo që me analizën e znj. Mevlude Shamolli, këto shifra ishin më të ulëta, të cilat do ta ndërronin edhe mendimin e Ministrit të Financave.

Arbërie Nagavci tha se pajtohet që projektligji për mësimdhënësit duhet trajtohet si prioritet dhe të përcillet tutje si Komision. Ajo tha se Sindikatat kanë deklaruar që do të kenë greva dhe që do të protestojnë, gjë që e destabilizon edhe procesin mësimor. Gjithashtu, ajo shtoi që do të ishte mirë sikur Komisioni të kërkonte nga ministrinë e linjës të shprehin qëndrimin e tyre zyrtar në një shkresë zyrtare sepse fjalët nganjëherë nuk po përputhen dhe që kjo do të lehtësonte marrjen e një vendimi përfundimtar.

Sa i përket raportimit të Ministrisë të Arsimit, ajo tha se është obligim ligjor i tyre të raportojnë jo vetëm në komision, por edhe në Kuvend çdo tre muaj, mirëpo që kjo nuk ka ndodhur asnjëherë, përveç kur Komisioni ka iniciuar seancë të jashtëzakonshme në lidhje me shkarkimin e Agjencisë. Gjithashtu ajo tha se sfidat e zbatimit të kurrikulës së re janë të jashtëzakonshme, ku tekstet mësimore ende nuk kanë mbërritur te të gjitha shkollat, sidomos ato të gjuhës angleze, vlerësimi i nxënësve dhe i performancës së mësimdhënësve, çështjet e arsimit të lartë tek universitetet publike dhe private, ku për këto dhe të gjitha çështjet e tjera do të raportonte jo vetëm në komision, por edhe në Kuvend sepse raportet në komision po janë shumë formale dhe nuk po ka hapësirë të mjaftueshme për të i diskutuar të gjitha problemet.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, lidhur me raportimin e Ministrisë të Arsimit, ajo tha se ministri ka shumëçka për të raportuar, sidomos për skandalin veror ku janë humbur 230.000 euro për padinë që i është bërë ministrisë nga ana e Kolegjit AAB, ku ministria nuk është ankuar për padinë dhe ka ndodhur një humbje e parasë publike. Ajo përmendi edhe qëndrimin e Ministrisë për mbylljen e Fakultetit të Energjetikes mbi arsyetimin se nuk ka kuadro. Në anën tjetër, për praninë e anëtarëve të Komisionit në mbledhjet e Agjencisë së Akreditimit, ajo tha se nuk do të duhej të ndodhte pasi që prania e deputetëve do të nënkuptonte politikë dhe vendimet do të ishin subjektive, mirëpo të kërkohet raportim nga ana e tyre. Ajo theksoi që komisioni nuk është kundër Ministrisë së Arsimit dhe që do ta përkrah, mirëpo që do të kërkojë edhe raportim nga ana e tyre në mënyrë që arsimit të shkojë përpara.

Sa i përket projektligjit të viteve të 90-ta, ajo tha se edhe pse ministrinë kanë ardhur me qëndrime të ndryshme, ajo është e interesuar të mos zhvillohet shumë politikë por që komisioni të angazhohet jashtëzakonisht shumë për një kohë të shkurtër dhe të punohet për një ligj të zbatueshëm edhe në praktikë.

Driton Çausi tha se pajtohet me propozimin e znj. Nagavci për qëndrimet zyrtare të ministrive, mirëpo që përvoja ka treguar që nuk janë shumë të suksesshëm në këtë drejtim. Ai propozoi që

Ministri i Financave të ftohet në takimin e komisionit në lidhje me projektligjin mbi statusin e mësimdhënësve dhe që është e rëndësishme që gjithë secili të marrë përgjegjësinë e tij.

Nezir Çoçaj tha që pas kalkulimeve të sakta, nuk do të dalë shifra aq e madhe sa kishte deklaruar Ministri i Financave, 60 milionë, mirëpo që do të jetë i përafërt me shifrën e Ministrit të Arsimit, 6-7 milionë. Ai propozoi që në takimin e ardhshëm në lidhje me këtë projektligj dhe pas kalkulimeve të sakta, të ftohen ministrat në fjalë dhe Kryeministri.

Arbërie Nagavci tha se ministratë duhet të jenë të pranishëm sepse deputetët nuk janë ekspertë të kalkulimit. Ajo gjithashtu tha se rrezikon të ndodhë e njëjta situatë si me ligjin për veteran të luftës, si dhe që shërbyesit e tjerë gjatë luftës të kërkojnë përfitimin e tyre, andaj, sipas saj, para vendimit përfundimtar, do të duhej të ishin të pranishëm edhe ekspertët e çështjes. Për fund ajo tha se propozimet e deputetëve, duhet të hidhen në votim.

Albulena Balaj-Halimaj propozoi që të organizohet një punëtori për projektligjin në fjalë, ku secili deputet do shprehte mendimet dhe idetë e tyre mbi koston përfundimtare të projektligjit, ku pas përfundimit të kësaj punëtorie, do të ftoheshin ministrat për diskutimet e radhës.

Ismajl Kurteshi tha se mbështet propozimin e znj. Balaj për punëtori dhe se kostoja e projektligjit varet se si komisioni e harton. Ai tha se Ministri i Arsimit e ka sponsorizuar këtë projektligj dhe do e mbrojë atë që ka thënë në fillim ndërsa Ministrit të Financave do të duhej ta ketë numrin e saktë të përfituesve dhe se a do të jetë e pranueshme për Ministrinë e Financave.

Arbërie Nagavci tha se Ministri i Arsimit duhet të raportojë sa mësimdhënës kanë punuar në atë kohë, sa kanë qenë personel tekniko-shërbyes, sa prej tyre janë gjallë, dhe sa prej atyre që kanë vdekur i kanë fëmijët nën moshën 18 vjeçare, sa bashkëpunëtorë kanë qenë në njësitë akademike sepse pa këto shifra të sakta nuk do t'ia dinim vlerën e koston.

Valentina Bunjaku propozoi që në punëtori të merrnin pjesë edhe zyrtarë të e Ministrisë së Arsimit dhe të Financave që bashkërisht të përpilohet ky projektligj.

Ismajl Kurteshi tha se nga diskutimet e anëtarëve të komisionit dolën dy propozime lidhur me shqyrtimin e mëtejme të projektligjit, andaj kërkoi që anëtarët e komisionit të deklarohen me votim lidhur me propozimet: 1) që ministri i Financave të jetë prezent në takimin e parë mbi këtë projektligj, 2) apo që komisioni të fillojë punën mbi këtë projektligj e pastaj të ftohet ministri.

Teuta Haxhiu tha se nëse ministrat vijnë me qëndrime dhe raporte zyrtare të shkruara, janë të mirëseardhur.

Nezir Çoçaj tha se vetëm po humbet kohë për shkak që ministratë i kanë qëndrimet e qarta dhe mbetet te komisioni që të fillojë shqyrtimin e këtij projektligji.

Driton Çaushi tha se Ministria e Financave, organizatat dhe institucionet tjera kanë shprehur qëndrimin e tyre karshi këtij projektligji, dhe që do të duhej që edhe Ministri i Arsimit të dalë publikisht para mediave të shpreh qëndrimin e tyre. Ai gjithashtu shtoi që asnjëri nga deputetët nuk është ekspert i financave dhe që komisioni nuk mund të vendosë se cilët bashkëpunëtorë të paguhen e cilët jo.

Komisioni me shumicë votash vendosi për propozimin e dytë që komisioni të fillojë punën mbi këtë projektligj e pastaj të ftohet ministri.

Ismajl Kurteshi shtoi që në takimin me ministrin e Arsimit mbi raportimin e tyre, MASHT-i të sjellë edhe planifikimin buxhetor për vitin 2019.

6. Të ndryshme

Kryetari i komisioni parashtrio çështjen e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Ankesave në Këshillin Shtetërorë të Cilësisë. Ai tha se Agjencia kishte kërkuar qëndrimin e komisionit sa i përket kësaj çështjeje, ku këta të fundit kishin dërguar disa materiale me propozime. Kryetari ftoi deputetët të shqyrtojnë këto materiale dhe të paraqiten me qëndrimin e tyre para Agjencisë lidhur me Komisionin e Ankesave.

Nezir Çoçaj propozoi që komisioni të realizojë një vizitë në Turqi për të parë funksionimin e institucioneve.

Ismajl Kurteshi tha që nëse janë mundësitet të vizitohet Presheva dhe Bujanoci, në mënyrë që të i ndihmohet këtyre institucioneve. Për fund ai propozoi që mbledhjen e ardhshme të komisionit, të bëhet përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore dhe të vazhdohet pastaj me shqyrtimin e projektligjit për statusin e mësimdhënësve të viteve të 90-ta.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi